



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

V E N D I M

Nr 46, Datë 13. 11.2019

PËR

**MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, LEHTËSIRAT
FISKALE, STRUKTURAT E VJELJES SË TYRE DHE ATO TË VENDOSJES SE
PENALITETEVE NDAJ KUNDRAVAJTËSVE**

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika1/1.3, germa “b”, neni 35, pika 4, neni 54, germa “f”, Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, Neni 5, germa “b”, “c” dhe “ç”, neni 7, neni 9, etj në vijim, Ligjin nr.9920 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Ligjin nr.115/2014 “Për Ndarjen Administrativo Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar, Ligjin nr.9723 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, Ligjin nr.10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, Ligjin nr.10465 date 29.09.2011 Për Shërbimin Veteriner në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.132, datë 07.0.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluejtëshme Ndërtesa, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënat për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, Udhëzimit nr.15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçensave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar, legjisllacionit të aplikueshem në fuqi, akteve nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara, Këshilli i Bashkisë Lezhë, pas diskutimit të anëtarëve ;

VENDOSI

I. Të bëjë ndarjen administrative territoriale të Bashkisë Lezhë, për efekt të diferencimit në ofrimin e cilësisë së shërbimeve, me qëllim bashkërendimin e tyre me nivelin e aplikimit të taksave dhe tarifave vendore, në tre zona si më poshtë :

- a. Zona A me përbërje: Nj.A. Lezhë dhe Nj.A. Shëngjin, Nj.A. Shënkoll.
- b. Zona B, me përbërje: Nj.A. Kolsh, Nj.A. Zejmen, Nj.A. Balldre.
- c. Zona C, me përbërje: Nj.A. Dajç, Nj.A. Blinisht, Nj.A. Ungrej dhe Nj.A. Kallmet,

II. Të caktojë si Agjent Tatimor, për vjeljen e Taksës mbi “Ndërtesat për Qëllime Banimi” dhe Tarifën për “Shërbimet Publike”, ndaj kategorisë së taksapaguesve si “Familjarë”, Drejtorinë e Sh.A. Ujësjetllës Kanalizime Lezhë, për ato familje që kanë kontratë furnizimi me ujë.

- a. Drejtoria e Sh.A.Ujësjetllës Kanalizime Lezhë, ka detyrim të përfshijë në faturën mujore për çdo abonent familjar, me të cilin ka lidhur kontratën për furnizimin me ujë të pijshëm, krahas detyrimit për konsumin e ujit të pijshëm edhe 1/12 e vlerës së taksës mbi ndërtesën dhe tarifës për shërbimet publike vjetore, të përcaktuar në këtë Vendim.
- b. Në rastet e mungesës ose mosparaqitjes së dokumentacionit nga abonenti familjar për sipërfaqen e ndërtesës, Drejtoria e Sh.A.Ujësjetllës Kanalizime Lezhë do t'i referohet VKM nr.132, datë 07.03.2018, neni 2, “Metodologjia për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluejtëshme “ndërtesa”, pika 2.1, germa “a”, duke e faturuar për sipërfaqen prej 100 (njëqind) m², deri në momentin e plotësimit të dokumentacionit për sipërfaqen e objektit, që përdoret për banesë nga abonenti familjar.
- c. E gjithë vlera e arkëtuar çdo muaj, do derdhet në llogarinë bankare të Bashkisë Lezhë, duke zbritur prej saj vlerën prej 1%, e cila do jetë vlera përfituese e Drejtorisë Sh.A.Ujësjetllës Kanalizime Lezhë, për rolin e Agjentit Tatimor.

III. Të miratojë, për të gjithë kategoritë e taksapaguesve dhe përfituesve të shërbimeve publike, të ofruara në territorin brenda juridiksionit të Bashkisë Lezhë, nivelin e taksave dhe tarifave vendore, afatet e pagesës, përjashtimet e lehtësirat fiskale për çdo zë, sipas kategorive përfituese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e tyre, të drejtën e ankimit për çdo vlerësim, arsyen e vendosjes së penaliteteve / gjobave për kundravajtjet e shkaktuara nga taksapaguesit, nivelin e tyre për çdo kundravajtje si dhe strukturat e ngarkuara për vendosjen e vjeljen e tyre, si më poshtë vijon :

A. TAKSAT VENDORE

Në zërin “TaksaVendore”, konform ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, përfshihen llojet e tyre si më poshtë :

1. Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin për Biznesin e Vogël.
2. Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme.

- a. Taksa mbi Ndërtesat,
 - b. Taksa mbi Tokën Bujqësore
 - c. Taksa mbi Truallin.
3. Taksa e Fjetjes në Hotel.
 4. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja.
 5. Taksa mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluajtshme.
 6. Taksa e Tabelës.
 7. Taksa të Përkohshme.

A.1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8.000.000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Parapagimi: Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Afatet e pagesës : Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill për muajt janar, shkurt e mars, brenda datës 20 korrik për muajt prill, maj e qershor, brenda datës 20 tetor për muajt korrik, gusht e shtator dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor.

Shkalla tatimore:Tabela sqaruese e aplikimit të shkallës tatimore për kategoritë e taksapaguesve

Nr	Tatimpaguesit sipas nivelit të xhiros	Njësia	Shkalla Tatimore
1	Me qarkullim vjetor nga 0-5 milion lekë	Lekë/vit	0 %
2	Me qarkullim vjetor nga 5-8 milion lekë		5% e fitimit

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tatimit: Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, në rolin e agjentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Për këtë shërbim Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Lezhë përfiton një komision prej 1% të të ardhurave të mbledhura.

A.2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- a. Taksa mbi Ndërtesën
- b. Taksa mbi Tokën Bujqësore
- c. Taksa mbi Truallin

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë ka të drejtë të bëjë një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë Bashkisë Lezhë, e cila më pas ka të drejtë, që të ngrejë një komision/grup pune, nga stafi i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, i cili bën matjen faktike në terren të sipërfaqes përkatëse dhe më pas ky akt konstatimi i kalon për vlerësim sektorit të Vlerësimit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, konform ligjit “Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore”, i ndryshuar.

A.2.a.Taksa mbi Ndërtesën

Baza e taksës është sipërfaqja në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Dokumentet, që vërtetojnë pronësinë janë Çertifikata e pronësisë, Vendimi i Komisionit të Kthimit të Pronave, Vendimi i privatizimit, etj, dokumentet konform legjislacionit në fuqi.

Nr	Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Niveli i taksës
1	Ndërtesa banimi	Lekë/m ² sipërfaqe shfrytëzuar	20
2	Ndërtesa për tregëti dhe shërbime, përfshi dhe zyra.		119
3	Ndërtesa për prodhim, prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme me to.		39.2
4	Ndërtesa për parkim :		
a	<i>Të Mbuluar</i>		55
b	<i>Të Hapur</i>		23.5
5	Ndërtesa që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësorë dhe blegtorale.		23.5

6	Për ndërtesat në proces ndërtimi, të cilat kanë tejkaluar afatin e lejes së ndërtimit.	30% e zërit përkatës të taksës
---	--	---------------------------------------

Kategorizimi i ndërtesave;

a. Ndërtesa banimi konsiderohen ato ndërtesa, të cilat përdoren nga qytetarët vetëm për qëllime banimi dhe jo për qëllime fitimprurëse si dhe ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi.

b. Ndërtesa për tregëti dhe shërbime, përfshi dhe zyra, konsiderohen ato ndërtesa, të cilat shfrytëzohen nga pronarët e tyre për qëllime fitimprurëse, që ushtrojnë aktivitete private në fushën :

-e tregtisë, si tregtim artikuj insdustrial dhe ushqimor, fruta perime, etj te ngjashme me to.

-të shërbimeve, si Agjenci bankare, këmbimi valute, doganore, hoteleri-turizëm, turizëm familjar, palestra, fitnes, pishina të hapura e të mbyllura, qendra shitje karburanti, farmaci, klinika, spitale, agjenci sigurimesh, agjenci transporti, autoservise, autoshkolla, Lavanteri, pastrim kimik, rojet civile, salla lojra të ndryshme, marangoz, riparime të ndryshme, parukeri / floktore, rrobaqepësi, etj te ngjashme me to.

-profesione të lira, si avokat, noter, studio konsulence, ekonomist, inxhinier, mjek, fondacione të ndryshme, etj te ngjashme me to.

c. Ndërtesa për prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industriale dhe ushqimore, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat, përpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie, letra, kartoni, shtypshkronjë, tulla, tjegulla, prodhime ushqimore, furrë bukë, prodhim konfeksione, prodhim dhe përpunim vajra, karburante, etj, prodhim dhe përpunim produkte farmaceutike dhe objektet e tjera të ngjashme me to.

d. Ndërtesa për parkim :

-të mbuluar, konsiderohen ato ndërtesa, që përdoren për ushtrimin e aktivitetit si shërbim parkimi për të tretët, në ambjente të mbyllura ose nëntokësore.

-të hapur konsiderohen ato ndërtesa, që përdoren për ushtrimin e aktivitetit si shërbim parkimi për të tretët, në ambjente të hapura.

e. Ndërtesa, që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, konsiderohen ato ndërtesa si stalla për bagëti, magazinat e ruajtjes së produkteve bujqësore e blegtorale, bimëve medicinale, etj te ngjashme me to.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës sipas kategorive të taksapaguesve janë :

- a. Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, për kategorinë “biznes”, strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila e kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës dhe kategorive në tabelën e cituar më lart. Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.
- b. Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, për kategorinë “familjarë”, që kanë kontratë me Ujësjiellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Ujësjiellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, ndërsa për ato familjarë, që nuk kanë kontratë me Drejtorinë e

Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, atëherë strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Në rastet e mungesës ose mos paraqitjes së dokumentacionit për pronësinë mbi ndërtesat:

- a. Kategoria “Familjarë”, që kanë kontratë me Drejtoria e Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, kanë detyrimin të dërgojnë tek ky Institucion çertifikatën e pronësisë së banesës, mbi bazën e të cilës do bëhet faturimi për taksën mbi ndërtesën. Në rast të mosparaqitjes së dokumentacionit të sipërcituar, atëherë do faturohet për një sipërfaqe banese prej 100 m², për çdo kryefamiljar, që ka kontratë me Drejtorinë e Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A.Lezhë.
- b. Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës mbi ndërtesat do t’i referohen VKM nr.132, datë 07.03.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluejtëshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”. Në rastet e konstatimit të mosdeklarimit të saktë të sipërfaqes së ndërtesës në përdorim nga ana e subjektit, atëherë do zbatohen procedurat e ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 116.

Afatet e pagesës së taksës :

- a. Për kategorinë “Biznes”, ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 30 Prill e vitit korrent. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Prill, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.
- b. Për kategorinë “Familjarë”, Taksa e ndërtesës do të paguhet me 12 këste të barabarta, të përfshira në faturën e ujit të pijshëm, kurse për familjarët, që nuk kanë kontratë me Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, taksa e ndërtesës do të paguhet me një këst të vetëm.

Përjashtime nga pagesa e taksës : Fitojnë përjashtime nga pagesa e taksës kategoritë:

- a. Pronat e shtetit dhe të njëjve tëqeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jo fitimprurese.
- b. Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me VKM, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
- c. Banesat sociale në pronësi të Bashkive.
- d. Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësit me qera të pa liberalizuara,
- e. Ndërtesat, që perdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre.
- f. Strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, “status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- g. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve, që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- h. Ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve, që trajtohen me ndihmë ekonomike;

- i. Ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore.

Për të përfituar këto lehtësira fiskale kategoria “Familjarë”, duhet të dorëzojnë tek Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, dokumentat e mëposhtëm:

- a. Çertifikatën familjare,
- b. Statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit,
- c. Librezën për paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit
- d. Vërtetimin nga Bashkia për përfituesit e ndihmës ekonomike.

A.2.b.Taksa mbi Tokën Bujqësore.

Përkufizimi : Tokë Bujqësore është ajo e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, çertifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Kategoritë e tokës	Njësia	Niveli i taksës
I	Lekë / Ha / Vit	3.920
II		3.430
III		2.940
IV		2.520
V		2.100
VI		1.680
VII-X		1.260

Strukturat përgjegjëse për vjeljen : Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore për të gjitha kategoritë, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë. Ngarkohet Drejtoria e Bujqësisë, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë. Ngarkohet sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Regjistrimit të Pronave, të saktësojë Aktin e marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme dhe ia percjell këtë informacion Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për llogaritjen e detyrimit.

Afatet e pagesës : Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 30 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Prill, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Për pronat e njohura nga komisioni i kthimit te pronave, sqarojmë se për personat, që i zoterojnë këto prona aplikohet taksa sipas natyres së pronës, nëse është tokë bujqësore, trajtohen si të tilla nëse janë pyje ose inproduktive, sipas ligjeve në fuqi.

Përrjashtime nga pagesa e taksës: Përrjashtohen nga pagesa e taksës mbi tokën bujqësore, ato që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

A.2.c.Taksa mbi Truallin

Baza e taksës: është sipërfaqja e truallit në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve, që e vërtetojnë atë. Taksa mbi truallin, nuk do të aplikohet për kategorinë familjarë, në ato ndërtesa banimi, të cilat bëjnë pjesë në kategorinë pallate banimi.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë Bashkisë ku ndodhet trualli. Pas deklarimit të bërë nga ana e subjektit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ka detyrimin të verifikojë në terren, me grupet e punës të sektorit të kontrollit, saktësinë e vetëdeklarimit të subjektit, jo më vonë se 10 ditë pas deklarimit. Në rastet e konstatimit të mosdeklarimit të saktë të sipërfaqes së truallit në përdorim nga ana e subjektit, atëherë do zbatohen procedurat e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 116.

Niveli i taksës: është në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Taksa e mbledhur, paguhet në buxhetin e Bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

Kategorizimi sipas qëllimit të përdorimit	Njësia	Niveli i taksës
Për qëllime banimi nga individët	Lekë / m ² / Vit	0.39
Për qëllime biznesi		14

Per çdo kategori minimale të truallit, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nën kategorizime.

Mënyra e pagesës: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 30 Prill 2019. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30Prill, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Ngarkohet Drejtoria Juridike / Sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Regjistrimit të Pronave, të saktësojë Aktin e marrjes se tokës në pronësi (AMTP), sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herë pas hershme dhe ia

percejell këtë informacion Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për llogaritjen e detyrimit. Më pas është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore struktura përgjegjëse e ngarkuar për llogaritjen dhe vjeljen e taksës mbi truallin për të gjitha kategoritë.

A.3. Taksa e Fjetjes në Hotel

Përkufizimi : Me Hotel, kuptohet çdo veprimtari, e cila jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet Hotel, Motel, Stabiliment Turistik, Pension, Shtëpi Pritje, Turizëm Familjar dhe çdo objekt tjetër, që përdoret për këtë qëllim.

Baza e taksës : Si bazë e taksës konsiderohet numri i netëve të qëndruara në hotel.

Niveli i taksës : Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga Këshilli i Bashkisë, për netë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel. Kjo taksë bazohet në ligjin nr.9632, date 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Nr	Kategoritë e njësive akomoduese hotelerike	Njësia	Niveli i taksës
1	Hotel me 4 & 5 Yje	Lekë /natë qëndrimi / Person	125
2	Hotel nën 4 yje, motel, hostel, bujtinë si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin.		50

Mënyra e pagesës: Detyrimi për taksën i takon klientit, që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit, në të cilën shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të shënohet vlera e taksës. Subjekti ka detyrim ligjor të kryejë pagesën për taksën e fjetjes në hotel, brenda datës 5 të muajit pasardhës. Kjo pagesë duhet të jetë e barazvlefshme me të dhënat e mbajtura në “**Regjistrin e Fjetjes**” në hotel, të cilat paraqiten për konfirmim tek Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore sa herë, që i kërkohet nga kjo e fundit. “**Regjistri i Fjetjes**” i çdo subjekti, që ushtron aktivitetin në fushën e shërbimit të hotelerisë, duhet të jetë i sekretuar dhe i çertifikuar nga Bashkia Lezhë. Në rastet e mosçertifikimit dhe mosparaqitjes së këtij regjistri, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, bën një vlerësim paraprak, duke marrë për bazë numrin e dhomave me një numër minimal prej 2 (dy) personash për çdo dhomë, me bazë ditore, për periudhën që subjekti është aktiv në sistemin tatimor.

Afati i pagesës : Pagesa kryhet brenda dates 5 të muajit pasardhës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës : Është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

A.4. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja.

Niveli i taksës: sipas kategorive dhe nën kategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë :

Nr	Kategorizimi i Ndërtimeve & Investimeve	Njësia	Niveli i taksës
----	---	--------	-----------------

1	a	Ndërtesa të destinuar për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi.	Në % të çmimit të shitjes/m ² .	4%
	b	Ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtezuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese.	Në % të çmimit të shitjes / m ² .	4%
	c	Ndërtimet e destinuar për qendra tregtare apo të biznesit.		
2	Ndërtime, që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike.		Në % të vlerës së investimit/ m ² .	2%
3	Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte. / Por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.			0.1%
4	Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi.			0.5%
5	Për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore.			1.5%

Baza e taksës : për pikën 1, është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njërive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave, ndërsa për pikat e tjera si pika 2, 3 4 dhe 5, shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

Mënyra e pagesës : Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit.

Afati i pagesës : Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Lezhë, vetëm pasi të kenë kryer pagesën për Taksën e Ndikimit në Infrastrukturë si dhe vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore se nuk kanë detyrime tatimore të palikujduara ndaj Bashkisë Lezhë deri në datën e paisjes me lejen përkatëse.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës : Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe lëshimin e faturës për pagesën e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja, është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, pranë Bashkisë Lezhë.

Përrjashtimet nga pagesa e taksës : Përrjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndertimin e strukturave akomoduese “Hotel/Resort me pesë yje, status special”, sipas përrcaktimit nëlegjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur nderkombëtarisht “*brand name*”, si dhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si “agroturizem”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

A.5 Taksa mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë për Pasuritë e Paluajtshme.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.

Nr	Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Niveli i taksës	
			Për Njësinë Lezhë	Për Njësitë e tjera
1	Ndërtesa banimi	Lekë / m ²	300	100
2	Ndërtesa për tregëti e shërbime		700	300
3	Ndërtesa të tjera		500	200

Mënyra e pagesës : Niveli i taksës caktohet në lekë/m² të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Strukturat përrgjegjëse për vjeljen e taksës: Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumësisë së arkëtuar, diferenca kalon për llogari të buxhetit vendor jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës. Ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Lezhë, që të bëjë rakordimet me ZVRPP Lezhë për planifikimin e të ardhurave.

Përrjashtime:

1. Përrjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

- a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
- b) Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”;
- c) Subjektet, që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
 - c.1) Institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
 - c.2) Bashkësitë fetare ose Organizatat Jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga Këshilli Bashkiak ose komunal për përrjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën, që i takon agjentit të taksave.

C.3) Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.

A.6. Taksa e Tabelës

Baza e taksës: Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror, që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet, që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

Nr	Kategorizimi i Tabelave	Njesia	Niveli i taksës
1	Tabela për qëllime identifikimi te veprimtarise se subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)		
a	Deri ne 2 m²		0
b	Mbi 2 m² deri ne 10 m²		
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	7.000
	Me ndriçim të thjeshtë		10.500
	Elektronike		14.000
c	Mbi 10 m² deri ne 20 m²		
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	5.950
	Me ndriçim të thjeshtë		8.925
	Elektronike		11.900
ç	Mbi 20 m² deri ne 40 m²		
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	3.850
	Me ndriçim të thjeshtë		5.775
	Elektronike		7.700
d	Mbi 40 m²		
	E thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m ² /vit	2.800
	Me ndriçim të thjeshtë		4.200
	Elektronike		5.600
2	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		
	Tabela identifikuese	Lekë/m ² /vit	84
3	Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, deri në tavanin maksimal 35 m².		
a	E thjeshtë (me/pa ndriçim)	Lekë /m ² /vit	15.750
b	Elektronike		31.500

4	Tabele në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj		
	Të të gjitha llojeve dhe përmasave	Lekë /m ² /ditë	700

Mënyra e pagesës: Detyrimi për taksën mbi tabelën është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga Bashkia.

Afati i pagesës për taksën mbi tabelat është sipas kategorive :

- a. Për kategorine 1-rë, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 Prill të vitit fiskal, ndërsa për subjektet, që duan të identifikohen me një tabelë të re pas datës 30 prill, detyrimi llogaritet dhe paguhet brenda 30 ditëve për periudhën nga data e deklarimit. Në rastin e më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese, ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.
- b. Për kategorinë e 2-të, për subjektet egzistuese detyrimi paguhet brenda datës 30 Prill të vitit fiskal, ndërsa për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë Lezhë.
- c. Për kategorinë e 3-të dhe të 4-t, detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Lezhë dhe paguhet menjëherë me marrjen e lejes.

Dhënia e Lejes për vendosje tabele për qëllime reklamimi : Në të gjitha rastet e kërkesës për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime identifikimi dhe reklamimi, të thjeshta dhe elektronike referuar pikave 1, 2, 3 dhe 4 në tabelën e mësipërme, subjekti duhet t'i drejtohet me shkrim Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban në Bashkinë Lezhë, me kërkesë për tú paisur me Leje. Kjo drejtori kryen të gjithë procedurat, që nga verifikimi, nëse kjo sipërfaqe që kërkohet për shfrytëzim nga subjekti është pjesë e hapësirave publike të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas të dhënave zyrtare të marra nga Drejtoria e e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban lidhur me sipërfaqen e tabelës, që do përdoret për qëllime reklamimi, të thjeshta apo elektronike, ka për detyrë regjistrimin në sistemin elektronik të Drejtorisë së Taksave & Tarifave Vendore dhe hartimin e faturës për arkëtim, sipas nivelit të taksës së miratuar në tabelën e sipërcituar. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, procedura kalon tek Drejtoria Juridike, e cila ka detyrimin e hartimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim për qëllimet përkatëse subjektit, i cili ka bërë kërkesën si dhe hartimin e Lejes sipas formatit të miratuar. Në fund fare, është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, struktura përgjegjëse për dhënien e Lejes subjektit.

Monitorimi i zbatimit të kontratës : Nëse gjatë ushtrimit të kontrolleve të përditshme në

terren, nga ana e inspektorëve të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohen raste të shfrytëzimit të hapësirave publike për vendosje të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike, mbi sipërfaqen e caktuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Lezhë si dhe të shfrytëzimit të hapësirës publike për qëllime të tilla, pa Leje dhe pa Kontratë, të lidhur me Bashkinë Lezhë, në të dyja rastet, inspektorët e kontrollit dhe verifikimit në terren, kane detyrim matjen e saktë të sipërfaqes së tabelës dhe mbajtjen e akt konstatimit për çdo rast. Ky akt konstatimi, i mbajtur nga inspektorët e Sektorit të kontrollit dhe Verifikimit në terren, i kalon për vlerësim tatimor, Sektorit të Vlerësimit dhe Regjistrimit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore me nivelin e taksave të cituar në tabelën e mësipërme, për sa kohë, që ajo sipërfaqe vazhdon të shfrytëzohet nga subjekti. Krahas kësaj procedure, është Sektori i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren në Dr.TTV, i cili harton dhe shkresën përkatëse për informacion për shfrytëzim të sipërfaqes së hapësirës publike, pa Lejen përkatëse nga Bashkia, për Policinë e Bashkisë, të cilat ndjekin procedurat e tjera, konform ligjit.

Afati i pagesës: Paradhënie, përpara paisjes me leje, e cila lëshohet vetëm pasi të jetë verifikuar kryerja e pagesës nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas kontratës së firmosur nga palët.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e taksës : Strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Lezhë.

A.7. Taksa të Përkohshme

Nuk ka taksa të përkohshme

B. TARIFAT VENDORE

Në zërin “Tarifa Vendore”, konform ligjit për Sistemin e taksave vendore, i ndryshuar, përfshihen llojet e tyre si më poshtë :

1. Tarifa për Shërbimet Publike
2. Tarifa për Zënien e Hapësirave Publike
3. Tarifa e Parkimit të Automjeteve
4. Tarifa për Shërbimet Administrative
 - a. Tarifa për Shërbimet Urbanistike
 - b. Tarifa për Shërbimin Veteriner
5. Tarifat për Çertifikimin dhe Liçencimin e Transportit të mallrave dhe Udhëtarëve.
6. Tarifa për Shfrytëzim të Ambjenteve të Institucioneve Vartëse.
7. Tarifa për Shërbimin e Akomodimit dhe Ushqimit ndaj fëmijëve, në Njësitë e Shërbimit në Kopështe dhe Çerdheve.
8. Tarifa për Dhënien e Liçencave për Tregtimin me Pakicë të Karburanteve, Gazit të Lëngshëm të Naftës, për Automjetet, Vajrave Lubrifikante dhe Lëndëve Djegëse, për Përdorim nga Konsumatorët Fundorë.

B.1. Tarifa e Shërbimeve Publike (pastrimit dhe largimit të mbetjeve, gjelbërimit, ndriçimit dhe dekorit)

Përkufizimi: Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Lezhë dhe njërive të saj administrative. Tarifa e shërbimeve publike paguhet nga të gjithë kategoritë e përfituesve, që ndahen në :

A. Familjarët,

B. Biznes,

C. Institucionet shtetërore.

për çdo vendndodhje të tyre.

Niveli i tarifës së Shërbimeve Publike: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura në tabelën si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Njësia	Niveli i Tarifave			
			A.Për çdo familje	B.Sipas Xhiros vjetore, në million lekë		C.Për çdo vendndodhje
				0-8	Mbi 8	
A	Familjaret					
a	Zona A	Lekë / muaj	200			
b	Zona B		100			
c	Zona C		100			
B	Biznesi					
1	Njësi Tregtare, si					
a	Mish	Lekë / vit		10.000	40.000	
b	Peshk			10.000	50.000	
c	Artikuj Fruta-perime, Ushqimorë, etj të ngjashëm me to			10.000	50.000	
ç	Artikuj industrial, veshje, parfumeri, këpuce, kanecalari, etj të ngjashëm me to.			4.000	26.000	
d	Bar – Kafe			9.000	32.000	
dh	Bar-Restorant, Fat-food, Piceri, etj të ngjashëm me to.			15.000	40.000	
e	Njësi tregëtimi lëndë djegëse, hidrokarbure, karburant, gaz, etj të ngjashëm me to.			10.000	50.000	
ë	Produkte farmaceutike të ngjashëm me to.			10.000	27.000	

2	Njësi Prodhimi					
a	Përpunim duralumin, metal, dru, letër, karton, plastmas, etj, të ngjashme me to.	Lekë / vit		10.000	50.000	
b	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gëlqereje, mermeri, nyje inerte, etj të ngjashme me to.			10.000	100.000	
c	Prodhim & përpunim artikuj ushqimorë si bukë, bylmet, pije alkalike, vaji, ëmbëlsira, etj, të ngjashme me to.			10.000	50.000	
ç	Perpunim mishi, peshku.			50.000	200.000	
d	Impiante, Territore për therjen e kafshëve, prodhim, përpunim produkte mish / peshk.			25.000	200.000	
dh	Prodhim & perpunim konfeskione, kepuce, veshje artizanale, Shtypshkronje, etj të ngjashme me to			10.000	80.000	
e	Prodhim energji elektrike, etj		0	200.000		
3	Njësi Ndërtimi					
a	Për çdo Seli	Lekë / vit		5.000	30.000	
b	Për çdo kantier ndërtimi					
b.1	Deri në 5 kate			20.000	50.000	
b.2	Mbi 5 kate			30.000	250.000	
c	Rikonstruksione të pjesëshshme			10.000	60.000	
4	Njësi Shërbimi					
a	Shkolla, Çerdhe, Kopështe, Azile pleqërie, Spitale, etj të ngjashëm me to.					
a.1	Njësi shërbimi deri në 200 persona	Lekë / vit		10.000	17.000	
a.2	Njësi shërbimi mbi 200 persona			15.000	25.000	
b	Riparim artikuj Elektroshtëpiak, Celulare, Radio, tv, Frigoriferë, Lavatriçe, Sobë, Biçikletë, Marangoz, Rrobaqepës, Këpucar, Orëndreqës, etj të ngjashëm me to			18.000	38.000	
c	Autoshkolla, Agjensi doganore, Shërbime kredi dhënie, Shërbime bankare, Agjenci transporti, Shërbime të rojeve civile, Agjensi			10.000	20.000	

	shitblerje prona, Menaxhim tregu i lire, etj të ngjashëm me to					
ç	Parukeri, Sallone për shërbim parukeri, Berber, Salla lojrash të ndryshme (palester për gjimnastike, fushë futbollit, tenis, etj, aerobie, cirqe, kënde lojrash për femijë, etj te ngjashëm me to			10.000	35.000	
d	Autoservise automjete dhe motorre, Gomisteri, Saldator, Tapiceri, etj të ngjashëm me to			10.000	35.000	
dh	Shërbime parkimi automjete, Shërbime vendosje skela ndërtimi, Shërbime sipërfaqe të gjelbërta, Shërbime telefonike, Shërbime TV, etj të ngjashme me to.			10.000	35.000	
e	Lavanteri, pastrim kimik, etj te ngjashëm me to.			10.000	25.000	
ë	Shërbime funerale, transporti, kablllore, etj, të ngjashëm me to.			10.000	25.000	
f	Shërbime fizioterapie, Shërbime klinike mjekesore, Shërbime klinike dentare, Laborator dentar, laborator analiza mjekësore, etj të ngjashem me to.			15.000	30.000	
g	Shërbime turizëm, me hapësira publike për shezlonge.					
g.1	Me sipërfaqe deri në 1.000 m ² .			15.000	50.000	
g.2	Me sipërfaqe mbi 1.000 m ² .			25.000	100.000	
gj	Shërbim hoteleri turizëm, dhoma pushimi, motel, stabiliment turistik, shtëpi pritje, turizëm familjar, hapësira publike per qellime plazhi, etj te ngjashem me to.	Lekë/d homë/vit		800	1.800	
h	Shoqata, OJF, etj të ngjashme me to	Lekë /vit		8.000	8.000	
5	Ambulant			2.000		
6	Njësi Profesione të lira					
a	Avokat, Noter, Shërbim përkthim	Lekë		4.000	15.000	

	gjuhë e huaj, Përmbaues, Zyrë Mjekësore, Ekonomist, Kurse mësuesie, Inxhinier, Studio Arkitekt & Projektues, etj të ngjashëm me to	/vit				
7	Njësi transporti tokësor					
a	Automjet pasagjerë					
	Përfshirë (4+1) deri ne Autobuze	Lekë / vit /mjet		2.000	15.000	
b	Automjet mallrash					
	Përfshirë të gjithë mjetet e transportit të mallrave	Lekë / vit /mjet		3.000	20.000	
8	Njësi transporti ujore					
a	Për pasagjerë	Lekë /vit		5.000	22.000	
b	Për mallra	/mjet		7.000	30.000	
9	Njësi peshkimi detare					
	Për çdo mjet peshkimi	Lekë / vit /mjet		10.000	35.000	
C	Institucione shtetërore					
a	Institucionet shtetërore	Lekë /m ² /sip.				400

Baza e tarifës, është llogaritur mbi koston e shërbimeve të ofruara në të gjithë territorin, i cili është nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë.

Niveli i tarifës : Llogaritet duke bërë një ndarje në përqindje të përfituesve të shërbimeve publik në tre kategori, “Familjarë”, “Biznes” dhe “Institucionet shtetërore”, ku peshën specifike kryesore e ka kategoria “Familjarë”, në masën e 55% të totalit të koston së shërbimeve, pastaj vjen kategoria “Biznes”, e cila zë peshën prej 43% dhe së fundmi kategoria “Institucione Shtetërore”, prej 3%.

Mënyra e pagesës: Për familjarët, që kanë kontratë me Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A. Lezhë, Tarifa e Shërbimit Publik do të paguhet me 12 këste të barabarta, sipas tabelës së mësipërme, të përfshira në faturën e ujit të pijshëm. Kurse për familjarët, që nuk kanë kontratë me Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A., Tarifa e Shërbimeve Publike do të paguhet me një këst të vetëm, në të njëjtën kohë me Taksën e Ndërtesës, Taksën e Truallit dhe Taksën e Tokës Bujqësore, për familjet që banojnë në fshat. Tarifa e Shërbimeve Publike, për kategoritë “Biznes” dhe “Institucione shtetërore”, do të kryhet me një këst të vetëm, të përfshirë në faturën për arkëtim, e cila llogaritet dhe hartohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Kategoria A. "Familjarët": Detyrimi paguhet me këste mujore të barabarta, të përfshira në faturën e ujit të pijshëm, për klientët e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A. Lezhë, ndërsa për ato familje, që nuk kanë kontratë me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A. Lezhë, detyrimet paguhet me një këst të vetëm, pranë Njësisë Administrative ku ato banojnë. Për çdo familje të krijuar rishtaz, afati i pagesës së tarifës së shërbimeve publike do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjëndjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj. Detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje. Për të llogaritur detyrimin për tarifën kjo kategori duhet të paraqesë pranë zyrës së Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, çertifikatën e gjëndjes familjare të lëshuar nga Zyra e Gjëndjes Civile.

Kategoria B. "Biznesi": Detyrimi paguhet brenda datës 30 Prill 2019. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet në përpjestim me muajt aktiv të subjektit. Për subjektet e regjistruara rishtaz detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKR. Për kategorinë "Njësi Ndërtimi", nën kategorinë "b", pika "b.1", dhe "b2", llogaritja e tarifës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë strukturave të Bashkisë Lezhë të kërkesës për leje shfrytëzimi. Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban ka detyrimin, që të informojë Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, çdo muaj, për numrin e Lejeve të Ndërtimit të dhëna shoqëruar me emërtesat e subjekteve, me të dhënat identifikuese NIPT dhe adresë ku do kryhet ndërtimi si dhe numrin e kateve të objektit, që do ndërtohet.

Kategoria C. "Institucionet Shtetërore": Detyrimi paguhet brenda datës 30 Prill 2019. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Prill, është 30 ditë pas lindjes së detyrimit.

Për të gjitha kategoritë: Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë, gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës: Struktura e ngarkuar për vjeljen e Tarifës së Shërbimeve Publike është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Lezhë.

Lehtësirat / përjashtimet nga pagesa e tarifës për shërbimet publike : Përjashtohen nga pagesa e Tarifës së Shërbimeve Publike:

- a. Familjet, që kanë krye-familjarin invalid;
- b. Familjet, që kanë në përbërjen e tyre, të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë,
- c. Familjet, që janë përfituese të ndihmës ekonomike;
- d. Pensionistët e vetëm ose me persona madhor të papunë.

Për të përfituar këto lehtësira fiskale, këto familje duhet të dorëzojnë tek Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A. Lezhë, dokumentat e mëposhtëm:

- a. Çertifikatën familjare,
- b. Statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit,
- c. Librezën për paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit
- d. Vërtetimin nga Bashkia për përfituesit e ndihmës ekonomike

B.2. Tarifa për Zënien e Hapësirave Publike

Baza e Tarifës për Zënie të Hapësirave Publike është sipërfaqja në metër katror, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit. Kategoritë dhe nënkategoritë e tarifës për zënien e hapësirave publike, sipas zonave të ndara sipas pikës II, të këtij vendimi, jepen si në tabelën e mëposhtme:

Nr	Kategoria	Njësia	Niveli i Tarifës		
			Zona A	Zona B	Zona C
1	Organizimin e spektakleve ose panairëve të ndryshme, kudo në çdo vendndodhje.	Lekë /m ² /ditë	300	300	200
2	Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si vendosje mallrash jashtë vendit të tregimit, vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqet të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe sende të tjera, etj të ngjashme me to.	Lekë /m ² /muaj	500	300	200
3	Zënia e hapësirës publike në Sheshin kryesor “Gjergj Kastrioti”.		50		
4	Zënie e hapësirave publike në zonat e plazhit				
a	Zona 1	Lekë / m ² / sezon turistik	500		
b	Zona 2		400		
c	Zona 3		350		
d	Zona 4		300		

Kufizimet e zonave të cituara në pikën 4, janë si më poshtë :

- a. Zona 1, Në veri nga Rëra e Hedhur deri në jug te zona Ushtarake
- b. Zona 2, Në veri nga Porti Shëngjin deri në jug subjekti Ara, përfshirë.
- c. Zona 3, Në veri nga subjekti Ara deri në jug Rruga e Knallës.
- d. Zona 4, Në veri nga rruga e Knallës deri në jug te Kunja e vogël, Vain, Tale.

Detyrimi i taksës për llogaritet si shumëzim i bazës (sipërfaqes) me nivelet treguese të saj.

Dhënia e Lejes për Shfrytëzimin e Hapësirës Publike : Në të gjitha rastet e përdorimit të hapësirës publike për të gjithë pikat e cituara në tabelën e mësipërme, subjekti duhet t’i drejtohet

me shkrim Drejtorisë së Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, me kërkesë për tú paisur me Leje “Për shfrytëzim të hapësirës publike”. Kjo drejtori kryen të gjithë procedurat, që nga verifikimi nëse kjo sipërfaqe që kërkohet për shfrytëzim nga subjekti është pjesë e hapësirave publike të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për dhënie për shfrytëzim për qëllimet e cituara në tabelën përkatëse, për biznes apo aktivitete të tjera dhe më pas kryen matjen në terren të sipërfaqes së kërkuar për shfrytëzim të hapësirës publike. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas të dhënave zyrtare të marra nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, lidhur me sipërfaqen në meter katror të hapësirës publike, që do jepet me qera, ka për detyrë regjistrimin në sistemin elektronik të Drejtorisë së Taksave & Tarifave Vendore dhe hartimin e faturës për arkëtim, sipas nivelit të tarifës së miratuar në tabelën e sipërcituar. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës, sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, procedura kalon tek Drejtoria Juridike, e cila ka detyrimin e hartimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim për qëllimet përkatëse subjektit, i cili ka bërë kërkesën si dhe hartimin e Lejes sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Në fund fare, është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, struktura përgjegjëse për dhënien e Lejes subjektit.

Në rastet e aplikimit për leje, sipas përshkrimit të pikës 3, hapësira publike në sheshin “Gjergj Kastrioti”, leja jepet vetëm në rastet e organizimit të aktiviteteve të tilla madhore, të cilat japin impaktin e duhur pozitiv në përshtatje me Planin Strategjik të Zhvillimit Ekonomik dhe Social të Bashkisë Lezhë.

Afati i pagesës: Paradhënie, përpara paisjes me leje, e cila lëshohet vetëm pasi të jetë verifikuar kryerja e plotë e pagesës, sipas formatit të lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Strukturat përgjegjëse: Për vjeljen e Tarifës për Shfrytëzimin e Hapësirave publike, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Strukturat përgjegjëse: Për monitorimin e zbatimit dhe respektimit të kontratës së lidhur për shfrytëzimin e hapësirës publike, janë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, IVMT dhe Policia e Bashkisë.

Monitorimi i zbatimit të kontratës : Nëse gjatë ushtrimit të kontroleve të përditshme në terren, nga ana e inspektorëve të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohen raste të shfrytëzimit të hapësirave publike mbi sipërfaqen e caktuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Lezhë si dhe të shfrytëzimit të hapësirës publike pa Leje dhe pa Kontratë, të lidhur me Bashkinë Lezhë, në të dyja rastet, inspektorët e kontrollit dhe verifikimit në terren, kane detyrim matjen e sipërfaqes së cituar më lart dhe mbajtjen e akt konstatimit për çdo rast. Ky akt konstatimi, i mbajtur nga inspektorët e Sektorit të Kontrollit dhe Verifikimit në Terren, i kalon për vlerësim tatimor, Sektorit të Vlerësimit dhe Regjistrimit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore me nivelin e tarifave të cituar në tabelën përkatëse të tarifave për shfrytëzimin e hapësirave publike, për sa kohë, që ajo sipërfaqe vazhdon të shfrytëzohet nga subjekti. Krahas kësaj procedure, është Sektori i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren në Dr.TTV, i cili harton dhe

shkresën përkatëse për informacion për shfrytëzim të sipërfaqes së hapësirës publike, pa Lejen përkatëse nga Bashkia, për Drejtorinë e IVMT dhe atë të Policisë së Bashkisë, të cilat ndjekin procedurat e tjera, konform ligjit.

B.3. Tarifa e Parkimit të Automjeteve

Zonat, sheshet dhe rrugët e lejuara për parkim, për t'u përdorur nga qytetarët, me dhe pa pagesë do jenë konform standarteve dhe legjislacionit përkatës në fushën e qarkullimit rrugor. Është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, struktura përgjegjëse për respektimin e këtyre standarteve, kryerjen e vijëzimit dhe vendosjen e tabelave, për të gjithë vendet e parkimit në çdo lagje dhe rrugë.

Tarifa e parkimit për zonat, sheshet dhe rrugët e lejuara për parkim, për t'u përdorur nga qytetarët, me pagesë, për të cilët do aplikohet kjo tarifë, do jetë sipas ndarjeve si më poshtë :

Nr	Kategoria	Njësia	Niveli i tarifës së parkimit		
			Vend Parkim i Miratuar me Pagesë (Vija Blu)	Vend Parkim i Rezervuar (vija Verdhë)	Vend parkime të miratuara si Stacione Qëndrimi
1	Autobuz	Lekë/vit			30.000
	Autoveturë/Taksi (8, 6, 4+1)			36.000	15.000
	Automjet mallra				35.000
2	Autobuz	Lekë/orë qëndrimi	300		
	Autoveturë/Taksi (8, 6, 4+1)		50		
	Automjet mallra		200		

Dhënia e Lejes për Parkim : Në të gjitha rastet e kërkesës së përdorimit të hapësirës publike për parkim të rezervuar për automjete, të cfarëdo lloji qofshin ato, subjekti duhet t'i drejtohet me shkrim tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, në Bashkinë Lezhë, me kërkesë për t'u paisur me Leje "Për shfrytëzim të Hapësirës Publike për Qëllim Parkimi të Rezervuar". Kjo drejtori kryen të gjithë procedurat, që nga verifikimi, nëse kjo sipërfaqe që kërkohet për shfrytëzim nga subjekti është pjesë e hapësirave publike të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për dhënie për shfrytëzim për qëllime parkimi të rezervuar ose ditore. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas të dhënave zyrtare të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, lidhur me numrin e vendeve të parkimit të rezervuar, që do jepet për shfrytëzim dhe llojin e mjetit të transportit, ka për detyrë regjistrimin në sistemin elektronik të Drejtorisë së Taksave & Tarifave Vendore dhe hartimin e faturës për arkëtim, sipas

nivelit të tarifës së miratuar në tabelën e sipërcituar. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, procedura kalon tek Drejtoria Juridike, e cila ka detyrimin e hartimit të kontratës për dhënien në shfrytëzim për qëllimet përkatëse subjektit, i cili ka bërë kërkesën si dhe hartimin e Lejes sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Në fund fare, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, struktura përgjegjëse për dhënien e Lejes subjektit.

Monitorimi i zbatimit të kontratës : Nëse gjatë ushtrimit të kontrolleve të përditshme në terren, nga ana e inspektorëve të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, konstatohen raste të shfrytëzimit të hapësirave publike për qëllime parkimi të rezervuar, mbi sipërfaqen e caktuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Lezhë si dhe të shfrytëzimit të hapësirës publike për qëllime parkimi të rezervuar, pa Leje dhe pa Kontratë, të lidhur me Bashkinë Lezhë, në të dyja rastet, inspektorët e kontrollit dhe verifikimit në terren, kane detyrim matjen e numrit të vendeve të parkimit dhe mbajtjen e akt konstatimit për çdo rast. Ky akt konstatimi, i mbajtur nga inspektorët e Sektorit të Kontrollit dhe Verifikimit në Terren, i kalon për vlerësim tatimor, Sektorit të Vlerësimit dhe Regjistrimit në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore me nivelin e tarifave të cituar në tabelën përkatëse të tarifave për shfrytëzimin e hapësirave publike, për sa kohë, që ajo sipërfaqe vazhdon të shfrytëzohet nga subjekti. Krahas kësaj procedure, është Sektori i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren në Dr.TTV, i cili harton dhe shkresën përkatëse për informacion për shfrytëzim të sipërfaqes së hapësirës publike, pa Lejen përkatëse nga Bashkia, për Policinë e Bashkisë, të cilat ndjekin procedurat e tjera, konform ligjit.

Afati i pagesës: Paradhënie, përpara paisjes me leje, e cila lëshohet vetëm pasi të jetë verifikuar kryerja e pagesës nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, sipas kontratës së firmosur nga palët.

Strukturat përgjegjëse: Për vjeljen e Tarifës për Shfrytëzimin e Hapësirave Publike për Qëllime Parkimi të Rezervuar” dhe të “Tarifës për Parkime Ditore” me orë qëndrimi, për automjetet e transportit rrugor, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Strukturat përgjegjëse : Për monitorimin e zbatimit dhe respektimit të kontratës së lidhur për shfrytëzimin e hapësirës publike, janë Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia e Bashkisë. Subjektet e biznesit të vogël mund të bëjnë kërkesë për tú paisur me leje shfrytëzimi hapësire publike për qëllime parkimi të rezervuar, **vetëm për një vendparkim**, ndërsa subjektet e biznesit të madh, **jo më shumë se dy vende parkimi**. Periudha e kohëzgjatjes së kontratave, për shfrytëzimin e hapësirave publike për vendparkimet e rezervuara, **nuk mund të jetë më e shkurtër se 6 muaj**.

Parkimet e rezervuara për autoveturat 6/4+1, ofrohen vetëm për kategorinë e taksapaguesve “Biznes” dhe “Institucione Shtetërore”. Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, ka përgjegjësi për vendosjen dhe mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale dhe horizontale për përcaktimin e vendit të parkimit, ndërsa shpenzimet për mbulimin e kostos për elementët e tjerë të përdorshëm, si ikonat birilat etj, mbulohen nga vetë biznesi, të prodhuara

sipas formatit, formës e ngjyrës, të propozuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit dhe të miratuar nga Këshilli i Bashkisë Lezhë.

B.4. Tarifat e Shërbimeve Administrative

B.4.1. Tarifat e Shërbimeve nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit & Zhvillimit Urban

Këto tarifa aplikohen në rastet kur banorët / subjektet aplikojnë në Bashki për çështje, që lidhen me shërbimet e ofruara nga kjo Drejtori.

Nr	Emërtimet / Zërat e Shërbimeve	Njësia	Niveli i Tarifës
1	Pranim dosje per shqyrtim për të gjitha llojet e aplikimeve		
a	Për nevoja biznesi	Lekë / dosje	10.000
b	Për shtëpi banimi		2.000
c	Për ndryshim destinacioni		5.000
ç	Tarifë për punime që kërkojnë deklaratë	Lekë	3 % e preventivit te punimeve,por jo me pak se 10,000 lekë
2	Njehsim i dokumenteve me origjinalin	Lekë /dokument	100
3	Kontroll i piketimit të rrethimit	Lekë / Kontroll	5.000
4	Kontroll i piketimit të objekteve		5.000
5	Kontroll pas përfundimit të themeleve		5.000
6	Kontroll pas përfundimit të karabinasë	Lekë / kat	10.000
7	Kontrolli përfundimit të rifiniturave, fasadat, përfshirë instalimet.	Lekë / m ²	50
8	Kontrolli përfundimit të sistemimit të jashtëm dhe lidhja me infrastrukturat inxhinierike.	Lekë	5.000
9	Azhornim genplanesh per leje ndertimi	Lekë / m ²	40
10	Matje e përcaktim i zonës së vendndodhjes së objektit	Lekë /dokument	3.000
11	Punime rikonstruksioni në godinat ekzistuese për familjarë	Lekë	3% e vleres se preventivit te punimeve, por jo më pak se 5,000 leke
12	Punime rikonstruksioni në godinat ekzistuese për shoqëri ndërtimi		3% e vleres se preventivit të punimeve, por jo

			me pak se 10,000 lekë
13	Tarife për lejen e kioskave provizore		100.000
14	Azhornime për reklama e zënie hapësirash publike	Lekë /dokument	2.000

Struktura përgjegjëse për hartimin e faturës për arkëtim dhe vjeljen e tarifës, për Shërbimet e kryera nga kjo Drejtori, sipas zërave të shërbimeve të cituara në tabelën e mësipërme, është Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban.

Mënyra e pagesës: Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, për çdo rast të ofrimit të shërbimit sipas zërave të cituara në tabelën e mësipërme, harton faturën përkatëse me emërtesën e zërit të shërbimit, nivelin e tarifës për atë zë shërbimi dhe vlerën e plotë, që del si rezultat i apkimit të kësaj tarife. Pas marrjes së faturës është detyrim i subjektit të kryejë veprimin e pagesës në Bankë / Arkën e Bashkisë. Pas verifikimit të kryerjes së pagesës nga ana e subjektit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, fillon procedurën për ofrimin e shërbimit të kërkuar.

B.4.2. Tarifa të Shërbimit Veteriner

Nr	Zërat e Shërbimeve	Njësia	Niveli i tarifës
1	Çertifikim Gjedhi/ Bagëti, të Rritur & të Imët, të therur	Lekë/kokë	100
2	Për çdo Kategori Peshku	Lekë / kategori	

Strukturë përgjegjëse për ofrimin e këtij shërbimi, çertifikimin / dhënien e lejes subjektit, si dhe dhënien e informacionit zyrtar për çertifikimet e kryera dhe lejet e dhëna, për çdo rast të kontrolluar, Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, është Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit & Kontrollit Veterinar e Ushqimor në vartësinë e Drejtorisë së Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve.

Strukturë përgjegjëse për vjeljen e tarifës : për ofrimin e Shërbimit Veteriner, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Mënyra e pagesës : Çdo ditë, pas kryerjes së kontrollit në të gjithë pikat e autorizuara si Thertore për bagëtitë, si dhe në çdo pikë e autorizuar për kategoritë përkatëse të peshkut, specialisti përkatës i Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit & Kontrollit Veterinar e Ushqimor, harton dokumentacionin e çertifikatës / lejes përkatëse, Mban aktin e konstatimit për çdo subjekt të kontrolluar, në të cilin shënohet numri i kokëve të therura / kategorisë së peshkut dhe nënshkruhet nga të dy palët, që janë Inspektori dhe Subjekti i kontrolluar. Ky informacion zyrtar, pasi kalon çdo ditë tek Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, vjen në fund të çdo muaji tek Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila bazuar në këtë dokument ka për detyrë regjistrimin në sistemin elektronik të Drejtorisë së Taksave & Tarifave Vendore

dhe harton faturën përmbledhëse mujore, të cilën ia dërgon subjektit përkatës me njoftim detyrimin për pagesë. Në rastet e therjeve nga individë, subjekti i thertores përkatëse arkëton vlerën nga individit dhe njëkohësisht i lind detyrimi për pagesën e taksës përkatëse ndaj Bashkisë, sipas procedurës së sipërcituar dhe nivelit në tabelën e mësipërme.

Drejtoria Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve ka detyrimin të bëjë pasqyrën përmbledhëse për dhënien e informacionit zyrtar për certifikimet e kryera dhe lejet e dhëna, për çdo rast të kontrolluar, ndërsa Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore harton pasqyrën përmbledhëse për të ardhurat e siguruara nga tarifat e shërbimeve përkatëse.

B.5. Tarifat për Çertifikimin dhe Liçencimin e Transportit të Udhëtarëve & Mallrave.

Nr	Emërtimet e Çertifikatave / Liçencave	Njësia	Niveli i Tarifës
A	Për Transportin e Udhëtarëve		
1	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/ 10 vjet	80.000
2	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rreth qytetëse		40.000
3	Liçensë për agjensi transport udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	Lekë / 5 vjet	15.000
4	Liçensë për agjensi ndërkombëtare për transport udhëtarësh		40.000
5	Liçensë për transport udhëtarësh me taksi brenda vendit		20.000
6	Liçensë për shërbim të rregullt të specializuar në transportin e udhëtarëve.		
7	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse.	Lekë / mjet / vit	1.000
8	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse		1.500
9	Çertifikatë për shërbim të rregullt të specializuar në transportin e udhëtarëve	Lekë / mjet / vit	1.500
10	Çertifikatë për transportin e udhëtarëve për llogari të vet.	Lekë / mjet / vit	1.500
11	Libër udhëtimi për shërbimet e rastit në transportin e udhëtarëve	Lekë / bllok	5.000
B	Për Transportin e Mallrave		
1	Liçensë për transport mallrash, për të tretë dhe me qera, brenda vendit.	Lekë / 5 vjet	40.000
2	Çertifikatë për transport mallrash, për të tretë dhe me	Lekë /ton	100

	qera, brenda vendit.	/vit	
3	Çertifikatë për transport mallrash, për llogari të vet, brenda vendit		

Bazë e tarifës: Niveli i Tarifave është i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi dhe Udhëzimeve përkatëse nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, referuar Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Udhëzimit nr.15, date 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të liçencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçensave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar.

Struktura përgjegjëse për hartimin e kriterëve dhe vjeljen e tarifës : Për hartimin e kriterëve, që duhen përmbushur nga subjekti për aplikimin për tú paisur me Çertifikatën dhe Liçencën, sipas kërkesës së tyre, konform ligjit dhe VKM përkatëse, strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas të dhënave zyrtare të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit lidhur me llojin e Çertifikatës apo Liçencës, ka për detyrë regjistrimin në sistemin elektronik të Drejtorisë së Taksave & Tarifave Vendore dhe hartimin e faturës për arkëtim, mbështetur në të dhënat e marra dhe sipas nivelit të tarifës së miratuar në tabelën e sipërcituar. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, procedura vazhdon përsëri tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, e cila, plotëson Liçencën / Çertifikatën e kërkuar nga subjekti, sipas formatit ligjor, të konceptuar nga kjo Drejtori dhe të konfirmuar për pagesën nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ndërsa për bazueshmërinë ligjore, të konfirmuar nga Drejtoria Juridike. Më pas formati i Liçencës / Çertifikatës, kalon për firmë tek Kryetari i Bashkisë. Në fund fare, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, struktura përgjegjëse për dhënien e Liçencës / Çertifikatës subjektit.

B.6. Tarifa për shfrytëzim të ambjenteve të Institucioneve vartëse

Drejtuesit e Institucioneve vartëse të Bashkisë Lezhë, kanë të drejtë të japin në përdorim ditor ose për një periudhë më të gjatë kohe për shfrytëzim nga të tretët për përdorim të ambjenteve të brendshme të tyre, gjithmonë pas miratimit nga Kryetari i Bashkisë apo personit të autorizuar, kundrejt tarifave përkatëse si më poshtë :

Nr	Kategoritë / Emërtimet e Ambjenteve	Njësia	Niveli i tarifës
A	Pallati i Kulturës		
1	Salla e Leksioneve / Mbledhjeve	Lekë/ përdorim	15.000
2	Salla e Madhe e Shfaqjeve		
<i>a</i>	Për të Rritur		15.000

<i>b</i>	Për Fëmijë	përdorimi	0
<i>c</i>	Për rastet kur organizuese e aktivitetit është Bashkia		0
3	Salla e Galerisë së Arteve		
<i>a</i>	Për ekspozita	Lekë/ditë/ përdorimi	5.000
<i>b</i>	Për piktorët e rinj		0
B	Biblioteka e qytetit		
<i>a</i>	Holli në katin e dytë	Lekë/ditë/ përdorimi	7.000
<i>b</i>	Holli në katin e tretë (Salla Fishta)		3.000
<i>c</i>	Hapje kartele lexuesi të rregullt	Lekë / kartelë / vit	100
<i>d</i>	Hapje kartele lexuesi për fëmijët		0
C	Muzeu & Memoriali		
<i>a</i>	Biletë hyrje vizitorësh për të rritur	Lekë / biletë	200
<i>b</i>	Biletë hyrje vizitorësh për fëmijë		100
D	Klubi Sportiv Besëlidhja		
<i>a</i>	Për shfrytëzim të ambjenteve sportive	Lekë/aktivitet	50.000
<i>b</i>	Biletë hyrëse në Stadium		
<i>b.1</i>	Në Tribunë	Lekë / Biletë	200
<i>b.2</i>	Jashtë Tribunës		100

Strukturat përgjegjëse për hartimin e kriterëve dhe vjeljen e tarifave: Institucionet vartëse, janë përgjegjëse për hartimin e kriterëve, që duhen përmbushur nga subjekti për aplikimin për të marrë në shfrytëzim ambjentet që janë nën administrimin e tyre. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas të dhënave zyrtare të marra nga Institucioni përkatës, ka për detyrë regjistrimin në sistemin elektronik të Drejtorisë së Taksave & Tarifave Vendore dhe hartimin e faturës për arkëtim, sipas nivelit të tarifës së miratuar në tabelën e sipërcituar. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, procedura vazhdon përsëri tek Institucioni, i cili plotëson Lejen e kërkuar, sipas formatit ligjor, të konceptuar nga Institucioni përkatës dhe konfirmuar për pagesën e kryer të subjektit nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ndërsa për bazueshmërinë ligjore nga Drejtoria Juridike, sipas formatit të miratuar. Në fund fare, janë Institucionet vartëse, struktura përgjegjëse për dhënien e Lejes për shfrytëzim të ambjenteve, në të cilën specifikohet qartë emri i subjektit, lloji i aktivitetit që do të zhvillohet, data / ora e zhvillimit dhe kohëzgjatja.

B.7. Tarifa për shërbimin e ofrimit të ushqimit ndaj fëmijëve, në Njësitë e Shërbimit në Kopështe dhe Çerdheve.

Nr	Kategoria e shërbimeve	Njësia	Niveli i Tarifës
1	Akomodim në Kopështe /Çerdhe	Lekë / muaj	E barabartë me koston e shërbimit

Baza e tarifës për shërbimin e ofruar do jetë kostoja në lekë/ditë qëndrimi për çdo fëmijë, kosto

e cila përfshin vetëm shpenzimet për ushqimin e fëmijëve, i cili është regjistruar në atë Njësi Shërbimi.

Strukturë përgjegjëse : Për llogaritjen e kostos dhe përgatitjen e formatit të faturës për arkëtim të nivelit të “Tarifës për Ofrimin e Shërbimit të Qëndrimit në Kopësht / Çerdhe”, është Drejtoria e Financës dhe Buxhetit. Për vjeljen e tarifës, Drejtoria përkatëse sipas informacionit të marrë nga Institucioni i Kopështit/Çerdhes së qytetit për numrin e fëmijëve të akomoduar gjatë muajit, harton faturën për arkëtim për çdo kryefamiljar.

Afati i pagesës : Për kryerjen e pagesës për regjistrimin në Kopësht / Çerdhe, kryefamiljarët janë të detyruar të bëjnë një pagesë paradhënie, në vlerën e shpenzimeve mujore të një muaji më parë, por jo më pak se 2.500 lekë. Më pas ato faturohen sipas kostos mujore nga Drejtoria përkatëse e sipërcituar, duke respektuar afatin jo më vonë se 10 ditë nga muaji pasardhës.

Lehtësirat fiskale : Do përfitojnë një zbritje në masën 50% të tarifës nga pagesa për Tarifën e shërbimit të akomodimit dhe ushqimit ndaj fëmijëve, në Njësitë e Shërbimit në Kopështe dhe Çerdheve, kategoritë e mëposhtme :

- a. Familjet që kanë krye-familjarin invalid,
- b. Familjet që kanë në përbërjen e tyre, të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë,
- c. Familjet, që janë përfituese të ndihmës ekonomike,

B.8.Tarifa për Dhënien e Liçencave për Tregtimin me Pakicë të Karburanteve, Gazit të Lëngshëm të Naftës, për Automjetet, Vajrave Lubrifikante dhe Lëndëve Djegëse për Përdorim nga Konsumatorët Fundorë.

Nr	Kategoria / zëri shërbimit	Njësia	Niveli i Tarifës
1	Për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante.	Lekë / Liçencë / 5 vjet	1.000.000
2	Për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë		100.000

Baza e Tarifës: Niveli i Tarifave është i përcaktuar sipas VKM nr.970, datë 02.12.2015. i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017.

Struktura përgjegjëse për hartimin e kriterëve dhe vjeljen e tarifës : Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, është përgjegjëse për hartimin e kriterëve që duhen përmbushur nga subjekti për aplikimin për tú paisur me Çertifikatën dhe Liçencën, sipas kërkesës së tyre bazuar në VKM nr.970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar me VKM nr.344, datë 19.04.2017. Më pas, nëse ky hap kalon, procedura vazhdon me

			Gjobës
1	Ndërhyrje në infrastrukturën rrugore		
a	Bllokim rruge & trotuari, si rrethim me materiale ndërtimi, etj të ngjashmë me to.	Lekë/rast	10.000
b	Dëmtim, çarje të rrugës apo trotuarit		
c	Ndotje të rrugës apo trotuarit		
ç	Dëmtim të paisjeve / materialeve të instaluar në rrugë /sheshe.		
d	Dëmtime në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të bardha		
2	Mosrespektim i rregullave për shërbimet publike		
a	Hedhja e mbetjeve (organike dhe të tjera të ndryshme) në ambjete publike, jashtë vendeve të miratuara nga Bashkia.	Lekë / rast	5.000
b	Mosrespektimi i orarit të hedhjes së mbetjeve urbane.		
c	Dëmtim sipërfaqe të gjelbërta, prerje pemësh, etj.		10.000
3	Shfrytëzim pa leje i hapësirave publike		
a	Për qëllime Biznesi	Lekë/rast	10.000
b	Për qëllime Parkimi automjete		1.000
4	Mospagesa në afat e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore		
a	Për kategorinë familjarë	Lekë/ditë	0.06 % të shumës së detyrimit, por jo më shumë se 365 ditë.
b	Për kategorinë Biznes		
c	Për kategorinë Institucione shtetërore		

Strukturat përgjegjëse për vendosjen e penaliteteve dhe vjeljen e tyre, sipas kategorive të shënuara në tabelën e mësipërme janë:

- a. Për shkeljet e shënuara në pikën një, dy dhe në pikën tre, është Policia e Bashkisë.
- b. Për shkeljet e shënuara në pikën katër, është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

D. Rakordimi dhe shkëmbimi i informacionit.

Çdo Drejtues Drejtorie, që është i ngarkuar si strukturë përgjegjëse për dërgimin e të dhënave zyrtare tek Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të dhëna të cilat i shërbejnë asaj Drejtorie për të përlllogaritur masën e detyrimit për taksapaguesin, mbi të cilat do të bëjë lëshimin e faturës për arkëtim të zërit të taksës apo tarifës përkatëse dhe njëkohësisht vjeljen e saj, ka detyrimin të mbajë një regjistër të protokolluar dhe data baze të veçantë, për çdo zë të taksave dhe tarifave për të dhënat e dërguara si dhe të rakordojë veprimet e kryera, çdo fund muaji, me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila më pas kryen raportimin mujor të realizimit të planit të të ardhurave, sipas zërave të planifikuar.

Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila sipas të dhënave zyrtare të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Publike lidhur me llojin e Çertifikatës apo Liçencës, ka për detyrë regjistrimin në sistemin elektronik të Drejtorisë së Taksave & Tarifave Vendore dhe hartimin e faturës për arkëtim, sipas nivelit të tarifës së miratuar në tabelën e sipërcituar. Pas marrjes së konfirmimit për kryerjen e pagesës sipas faturës së lëshuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, procedura vazhdon përsëri tek Drejtoria e Shërbimeve Publike, e cila, plotëson Liçencën / Çertifikatën e kërkuar nga subjekti, sipas formatit ligjor, të konceptuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe të konfirmuar për pagesën nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ndërsa për bazueshmërinë ligjore, të konfirmuar nga Drejtoria Juridike. Më pas formati i Liçencës / Çertifikatës, kalon për firmë tek Kryetari i Bashkisë. Në fund fare, është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës, Transportit dhe Mjedisit, struktura përgjegjëse për dhënien e Liçencës / Çertifikatës subjektivit.

C. ANKIMIMI

Çdo taksapagues ka të drejtë të ankohet me shkrim për shumën dhe mënyren se si janë vlerësuar detyrimet e tij, të kërkojë rimbursime si dhe të apelojë kundër çdo veprimi ose mosveprimi nga strukturat e Drejtorive përkatëse në Bashkinë Lezhë.

Ankimi paraqitet me shkrim pranë Kryetarit të Bashkisë brenda 30 ditëve nga marrja dijani për aktin administrativ, dhe përmban:

- a) emrin, adresën dhe NIPT-in e apeluesit;
- b) vitin tatimor, me të cilin lidhet apelimi;
- c) natyrën dhe shumën e tatimit ose gjobës që është subjekt apelimi;
- d) baza ku mbështetet apelimi.

Subjekti duhet të përmbushë kërkesat e ligjit për parapagimin e detyrimeve përpara depozitimit të ankimit administrativ.

Procedurat e apelimit dhe procedurat e shqyrtimit të apelimit tatimor, bazohen në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar, neni 7, në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave, në zbatim të tij.

Spektori i Apelitit Tatimor, shqyrtton ankimin dhe merr vendim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Kundër vendimit të Sektorit të Apelitit, subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative, brenda 30 ditëve nga çasti i marrjes në dijani për vendimin e mësipërm.

C. Penalitetet / Gjobat

Për çdo rast të moszbatimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj dhe në këtë vendim, ndaj çdo kundravajtësi do ketë penalitete, sipas kategorisë dhe shkeljes si më poshtë :

Nr	Emërtimi / Përshkrimi i shkeljes	Njësia	Niveli i Penalitetit /
----	----------------------------------	--------	------------------------

- IV. VKB Lezhë nr.5, datë 28.01.2019 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore” dhe VKB nr.24, datë 21.02.2019 “Për lënien në fuqi të VKB Lezhë nr.5, datë 28.01.2019 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore”, shfuqizohen.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe i shtrin efektet e tij, duke filluar nga data 01 Janar 2020 e në vijim.

**KRYETARI
ERNEST RAKAJ**

